



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:173785

Datë: 12.07.2024

Numri i dokumentit: 05934621

Kom.Dh.shk.II.nr.167/24

GJYKATA KOMERCIAL E KOSOVËS E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtaren individuale Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen përmbartimore të kreditorit NTP “ECTRON”, me numër të biznesit 70394192, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat Zef Berisha., avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Standard” Sh.P.K., me numër të biznesit 80100540 dhe seli në Prishtinë, rr. “Dardania”, SU 1/3A, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Mustafë Kastrati., avokat nga Peja, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1276/23 të datës 21.11.2023, me datën **12.07.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit “Standard” Sh.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1276/23 të datës 21.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1276/23 të datës 21.11.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Standard” Sh.P.K., me numër unik identifikues 80100540 dhe seli në Prishtinë, i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 277/23, të lejuar me datë 12.07.2023, nga Përmbaruesi Privat Besnik F. Nuhiu.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori NTP “ECTRON”, ka paraqitur propozimin për përmbarim, në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Ekonomike, EK.nr. 349/13, të datës 15.11.2021, ka lejuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 277/23, të datës 12.07.2023, me të cilin ka urdhëruar debitorin “Standard” Sh.P.K., që në emër të përmbushjes së obligimeve sipas aktgjykimit, t’ia paguaj kreditorit borxhin në lartësi prej EUR 97,971.39, me kamatë si për mjetet e depozituara për një vit në bankat e Kosovës, pa denstimin të caktuar, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë, data 03.05.2013 e deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej EUR 4,675.79, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim në lartësi prej EUR 312.00.

Përmbaruesi Privat Besnik F. Nuhiu, me seli në Gjiilan duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ka nxjerrë urdhrin përmbarimor P.nr.277/23 i lejuar me datën 12.07.2023.

Debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afati ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetim se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbarimor nuk ka titull ekzekutiv ose tipare të përmbarueshmërisë. Ndërsa, ka shtuar se propozimi i kreditorit është i parakohshëm ngase ndaj aktgjykimit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri është paraqitur revizion, dhe me ekzekutimin e tij debitorit i shkaktohet dëm përtej mase. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, urdhri përmbarimor të refuzohet si i pa bazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar prapësimin duke i propozuar gjykatës që të refuzojë në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1276/23 të datës 21.11.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Standard” Sh.P.K., me numër unik identifikues 80100540 dhe seli në Prishtinë, i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 277/23, të lejuar me datë 12.07.2023, nga Përmbaruesi Privat Besnik F. Nuhiu.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata Komerciale- Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj konkludimi e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe

vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit lidhur me atë se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përbarimore, për faktin se në rastin konkret dokumenti përbarues në bazë të cilit është lejuar përbarimi është aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Ekonomike, EK.nr. 349/13, të datës 15.11.2021 , i plotfuqishëm më datë 04.05.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 21.06.2023. i cili në rastin konkret është dokument përbarues, e kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se: *“dokument përbarimor është vendimi përbarues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përbaruese”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: *“dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje dhe interpretim të gabuar të dispozitave të LPP-së, me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Kjo gjykatë ka vlerësuar se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Ekonomike, EK.nr. 349/13, të datës 15.11.2021 , i plotfuqishëm më datë 04.05.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 21.06.2023., në bazë të dispozitave të nenit 21 dhe 22 të LPP-së është dokument përbarues dhe në këtë rast përbejnë bazë juridike për caktimin e përbarimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 24 dhe 27 i LPP-së, për të qenë i përbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përbarim. Prandaj, Gjykata Komerciale- Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejte ka vepruar kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, sepse nuk ekziston asnjë nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit të cilat janë të parapara me nenin 71 të LPP-së.

Gjykata mori parasysh pretendimet ankimore të debitorit se propozimi për përbarim është i parakohshëm ngase ndaj aktgjykimit në fjalë është paraqitur revizioni pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara ngase revizioni i paraqitur nuk është pengese

për ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm, kjo në kuptim të nenit 213 të Ligjit për procedurën kontestimore.

Nuk janë pranuar as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata përmbarimore me saktësi ka konstatuar rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi përfshirë edhe kushtet formale nga të cilat varet lejueshmëria e përmbarimit.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS E KOSOVËS,

Dhomat e shkallës së dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.167/24, me datën 12.07.2024

Gj y q t a r j a,

Saranda Bogaj – Sheremeti